

RELACION TEKNIK

**PËR PROJEKTIN: “RIKONSTRUKSION RRUGA "BREGU I HAZËS",
FAZA I, Nj/A QUKËS, BASHKIA PRRENJAS”**

Vendi i ndërtimit - Bregu i Hazes, Qukës Shkumbin, Njësia administrative Qukës,
Bashkia Prrenjas

Qëllimi i ndërtimit - Përmirësimi i infrastrukturës rrugore të lagjes

Hartimi i projektit është mbështetur si më poshtë:

I- Gjendja aktuale rrugës së Xhamisë.

II- Zhvillimi i projektit për: “Rikonstruksion rruga "Bregu i Hazës", Nj/A Qukës, Bashkia Prrenjas ”

**I- Gjendja aktuale rrugës Bregu i Hazes, Qukës Shkumbin, Nj/A Qukës,
Bashkia Prrenjas”**

Rruga ka një gjatësi prej 234 ml dhe një disnivel 16 ml, pasi rruga ka një terren kodrinor në ngjitje dhe në zbritje dhe gjendja ekzistuese e rrugës të lagjes së re nuk i përgjigjet kërkesave të banoreve në transportin me makinë pasi makinat për vetë terrenin malor të rrugës nuk futen në lagje pasi rruga nuk është shtruar as me asfalt dhe as me beton .

Rruga ka një strukturë të fortë shkëmbore dhe në forme të shkatërruar.

Rruga shërben dhe si një lidhëse midis lagjeve të shkollës mesme, lagjes Shyti, lagjes Kopaçi, lagjes Alliu me një popullsi afërsisht 1000 banorë.

Duke u nisur nga kërkesat e vazhdueshme dhe shqetësim të banorve për të bërë rikonstruksion të rrugës, nga Bashkia Prrenjas ky shqetësim është parë me përparësi dhe është vlerësuar shqetësimi dhe Drejtoria Urbanistike ka hartuar projektin e detajuar për rikonstruksionin e rrugës.

Rruga ka permbajtje dheri gure , dhe materiale të tjera të panevojshme të cilat me rikonstruksionin do të hiqen do të skarifikohet rruga dhe do të shtrohet me beton .

Rruga ka një shtrirje Veri -jug dhe do të rikonstruktohet një segment me gjatësi 234 ml. Rruga ka një gjerësi 3.5 ml dhe në të gjithë gjatësinë e saj ka kanal anesor me permasa 0.25 x0.25 cm për të kaluar ujërat e krijuara nga shirat dhe nga ujrat e burimeve familjare .

Rruga do te shtrohet me beton te markes M-300 me hekur poshte me shtrese zhavori te tipit granil. Trashesia e betonit eshte 15 cm.


Gjate hedhjes te betonit ,siperfaqes te betonit do ti jepet siperfaqe e ashper me kanale te vogla deri 2 cm per te kulluar ujrat me pjerresi nga kanali.

Foto te gjendjes ekzistuese









II- Zhvillimi i projektit për: “Rikonstrukcion rruga "Bregu i Hazës", Nj/A Qukës, Bashkia Prrenjas ”

Vleresimet e fortesise te tabanit te rruges bazohen ne njohjen e tipit te dheut dhe se si dheu reagon ndryshimeve te permbajtjes te lageshtise ne kushte ambientale te vecanta kundret ngjeshjes.

Nga kjo njohuri eshte bere nje vleresim i fortesise se tabanit te rruges ne lidhje me permbajtjen e lageshtise dhe gjendjen e ngjeshjes qe mund te ndodhe ne terren. Cilesia e materialeve te shtresave merret ne perputhje me specifikimet teknike .

Per llogaritjen sipas metodologjise duhet te kemi parasysh konceptet si kapaciteti struktural (numri struktural) qe shpreh fortesine e tabanit.

Shtresa e re si granil, e cila do te rullohet ose ngjeshet me makineri, vendosja e hekurit Ø 10 dhe 8 mm, menyra e vendosjes se hekurit lidhja e dy Ø -ve me njera tjetren.

Vendosja e shtreses te betonit mbi hekurin do te behet pasi hekuri te jete fiksuar mire dhe te jetë i shtrire mire pa pengesa te tjera te copave te ngelura te hekurit me maje, qe mund te dalin mbi beton .

Hekuri duhet te fiksohet ne toke me ganxha te cilat ngulen ne te dy anet e rruges ne cdo 3.0 ml per te mos rreshqitur hekuri gjate betonimit.

PERZIERJA E BETONIT.

Perzierjet dhe llojet e ndryshme te betonit do te perfitohen ne perpjestim me rregullat qe pefitojne fortesine e kerkuar.

Permbajtja e ujit ne beton duhet te kontrollohet rigorozisht dhe te mbahet ne minimumin e kerkuar per te perfituar nje beton te pershtatshem e punimit qe do te kryhet.

Ne asnje rast nuk duhet qe raporti i ujit dhe çimentos nuk duhet te kaloje raporti uje /cimento te kaloje 0.50%.

Shkalla e perzierjes te betonit percaktohet nga nje numer i cili eshte fortesia 28 ditore qe tregon se betoni e ka fituar fortesine kerkuar (ose koinsistencen).

Relacioni tekniko ekonomik i projektit duhet te perfshije:

1. Planimetri aksiale .
2. Profile gjatesore te rruges.
3. Vizatime te profileve gjatesore dhe terthore te rruges.
4. Relacion tekniko ekonomik i projektit per pershkrimin e gjendjes ekzistuese.
5. Preventivi i plote i zbatimit te punimeve sipas Vendimit nr. 216, datë 13.4.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.
6. Grafik punimesh.

Konkluzione

Nga verifikimet ne terren dhe nga llogaritjet konkludojme se është e domosdoshme sistemimi dhe betonim i rrugës së Xhamisë, Qukës Shkumbin, Nj/A Qukës.

Me ndërtimin e “Sistemim dhe betonim i rrugës së Xhamisë, Qukës Shkumbin”, Nj/A Qukës, bashkia Prrenjës, banorët e ketyre lagjeve do të kenë një rrugë me të gjithë elementët dhe me parametra bashkëkohor.

Relatoi: Ing. Kastriot Begaj